

PROCESVERBAL 24/2022

I mbajtur me rastin e takimit të 5 (pestë) për vitin 2022 të Komunitetit për Komunitete, mbajtur me datë 24.05.2022 duke filluar nga ora 9:00.

Rend dite

1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

2.Shqyrtimi i projekt - vendimit për miratimin e propozimeve të komisionit për dhënien e shpërblimeve “Emblema e artë” dhe mirënjohjes “13 Qershori” ;

3.Shqyrtimi i projekt - vendimit për bonos banim;

4.Shqyrtimi i projekt - vendimit për ti ndihmuar klubit të futbollit “Ballkani” ;

5. Të ndryshme;

Takimin e hapi Kryesuesi i komitetit për Komunitete z.Denis Sofra dhe i njoftoi me rendin e ditës.
Kryesuesi - a pajtoheni me rendin e ditës?

Aprovohet

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - a pajtoheni me procesverbalin?

Aprovohet.

Pika 2. Shqyrtimi i projekt - vendimit për miratimin e propozimeve të komisionit për dhënien e shpërblimeve “Emblema e artë” dhe mirënjohjes “13 Qershori” ;

Kryesuesi - i njofton me rendin e ditës dhe për elaborim ia jep fjalën zyrtarit ligjor.

Avni Bytyqi - Komuna çdo 13 qershor ndan shpërblime dhe mirënjohje në bazë të vendimit të Asamblesë. Është komisioni që është miratu nga Asamblea, i cili ka ndjek të gjitha procedurat. Për “Emblemën e artë” është propozu Bislim Zyrapi, për mirënjohjen “13 Qershori” janë propozu 5 persona dhe ata janë: Avdullah Melit Morina nga Samadraxha, Enver Malush Zeqaj nga Samadraxha, Shefki Muqaj nga Suhareka, Afrim Sylaj nga Sllapuzhani, Qazim Musaj nga Samadraxha.

Kryesuesi - e hedh në votim.

Aprovohet

Pika 3. Shqyrtimi i projekt - vendimit për bonos banim;

Kryesuesi - i njofton me pikën dhe për elaborim ia jep fjalën zyrtarit ligjor.

Avni Bytyqi - çdo vit Komuna planifikon një shumë të parave e cilat jepet për bonos banim. 7 familje financohen me 40 % të banimit. Zakonisht përfitojnë familjet që nuk kanë pronë individuale dhe zakonisht janë gra vetushqyese dhe gra të cilat kanë pësuar dhunë në familje.

Kryesuesi - kisha dasht me bo një analizë sa i përket komuniteteve, që mos ka ndonjë familje që mundet me hy në këtë kategori.

Avni Bytyqi - si procedurë hapet një ofertë.

Kryesuesi - a do të vazhdohet kjo vetëm për ata që janë apo do të shpallet konkursi i ri .

Avni Bytyqi - shpallet oferta e re për çdo vit.Fitimi i kësaj shumë bëhet për një vit.

Kryesuesi - kemi 5 familje,ku disa prej tyre kanë fillu ndërtimin e shtëpive sa i përket projektit të Halil Kastratit me Komunën,por kemi një familje e cila ka mbet aty,shpresoj mos ndoshta hyn në këtë projekt.

Avni Bytyqi - realisht këtu paguhet qeraja,rreth 40 %,mirëpo procedura zhvillohet për krejt ,pa dallim.

Kryesuesi - e hedh në votim.

Aprovohet

Pika 4. Shqyrtimi i projekt - vendimit për ti ndihmuar klubit të futbollit “Ballkani” ;

Avni Bytyqi - është kërkesë nga klubi i “Ballkanit”,i cili kërkon me ndihmu Komuna. Ekziston vullneti i Kryetarit që të ndihmohet,mirëpo procedurat duhet të kalohen.Jemi dëshmitarë për të arriturat e Ballkanit dhe mbetet të diskutohet në Asamble.

Kryesuesi - e hedh në votim.

Aprovohet

Pika 5. Të ndryshme;

Kryesuesi - a ka diçka me shtu te kjo pikë.Nuk ka.

Takimi përfundoi: 09:15